



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr.648/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rustem Thaçi dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në rrjete sociale facebook, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 20.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa: Anr.648/2021 e datës 18.10.2021, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, të paraqitura kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore

A r s y e t i m

Me datë 18.10.2021, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.648/2021, të paraqitur nga Organizata BIRN dhe Internews Kosova, kundër Avdullah Hoxha kandidat për asamble Komunale në Pejë nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), në të cilat pretendon se me datën 17 tetor 2021, përmes rrjetit social facebook ka sponsorizuar një postim me anë të cilit ka kërkuar nga qytetarët që ta votojnë, ku ky postim i sponsorizuar u është shfaqur përdoruesve të këtij aplikacioni ditën e zgjedhjeve dhe në këtë mënyrë ka ndikuar tek të njëjtit për mënyrën e votimit. Sipas parashtruesit të ankesës kandidati në fjalë ka thyer heshtjen zgjedhore veprime këto që bien ndesh me Planin Operacional të Zgjedhjeve Lokale dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikës së Kosovës. Si dëshmi ka bashkangjitur foton e marrë nga platforma e rrjetit social facebook.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik AAK e mohon se ka ndodhur shkelja e supozuar pasi që parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar deheri të qarta dhe bindëse pasi që nga fotot nuk mund të vërtetohet se reklamat janë publikuar apo kane vazhduar edhe në ditën e heshtjes zgjedhore pasi që me asnjë prove nuk është argumentuar data dhe ora e reklamave që pretendohet se janë publikuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale,, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, me datë 18.10.2021 ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se e njëjta është e pabazuar ngase nuk ka qenë e mundur të vërtetohet në rrugë elektronike nëse e njëjta me datën 17 tetor 2021 ka qenë aktive, pasi që në kohën e testimit e njëjta ka qenë jo aktive.

Duke marrë parasysh të cekurat më lartë, Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve për ankesat, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se shkelësi i supozuar me datë 17.10.2021, e ka vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore në rrjetin social "Facebook", edhe në ditën e heshtjes zgjedhore dhe ditën e votimit.

Nga provat e ofruara nga ankuesi, nuk mund të vërtetohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se reklama e shkelësit të supozuar është publikuar apo ka vazhduar sponsorimi i fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore dhe ditën e votimit, edhe pse parashtuesi i ankesës ka paraqitur fotografi me të cilat pretendon se postimi i sponsorizuar ka qenë aktiv në ditën e votimit, paneli këto pretendime nuk mundi ti vërtetoj sepse me asnjë provë shkresore nuk është argumentuar ashtu siç pretendohet në ankesë.

Paneli, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, me datë 18.10.2021, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se të njëjtat janë të pa bazuara ngase nga ekzaminimi i bërë shihet se llogaria e kandidatit Avdullah Hoxha nuk ka qenë aktive dhe nuk kishte sponsorizim..

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.648/2021 më datë 20.10.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.